



Raport i grupit punues për shqyrtimin e modelit të qeverisjes së mëtejme të Koalicionit për KOMRA

Të emëruar në Kuvendin e Koalicionit për KOMRA në Jahorinë

Në Kuvendin e Koalicionit për KOMRA është emëruar Grupi punues për shqyrtimin e modelit të qeverisjes së mëtejme në përbërjen e mëposhtme: Vesna Tersheliç, (nga Kroacia), Daliborka Uljareviq (nga Mali i Zi), Milena Saviq, (nga Bosnja dhe Hercegovina), Dragan Pjevaç, (nga Serbia), Nora Ahmetaj, (nga Kosova), Gordana Duvnjak, (nga Maqedonia) dhe Aleksandar Todoroviç, (nga Sllovenia).

Me ftesën e *Documente* në takimin në Zagreb, në datën **25. 10. 2014** në Shtëpinë për të Drejtat e Njeriut janë takuar Vesna Tersheliç, Daliborka Uljareviq, Milena Saviq, Dragan Pjevaç dhe Gordana Duvnjak. Nora Ahmetaj është inkuadruar përmes telefonit. Miku ynë Aleksandar Todoroviç, fatkeqësisht, në ndërkohë ka ndërruar jetë. Acën nuk mund ta zëvendësojë askush. Megjithëkëtë, e kemi ftuar Igor Mekinën dhe Mirjana Uçakarin me propozimin për t'u inkuadruar në emër të anëtareve të Koalicionit për KOMRA nga Sllovenia. Igori nuk ka mundur për të ardhur për shkak të sëmundjes së babait, por e ka dërguar mendimin në formën me shkrim. Deri te Mirjana nuk ia kemi dalë të arrijmë.

Takimin e kanë përcjellë edhe Katarina Kruhonja, anëtare e Këshillit Koordinues dhe Eugen Jakovçiq nga *Documente*. Nga grupi punues, i cili vërteton nëse ka ndodhur shkelja e Statutit të Koalicionit për KOMRA, ka marrë pjesë Veljko Viçeviq.

Në fillim të takimit e kemi theksuar se në përpunimin e projektit të modelit të ri të qeverisjes me Koalicionin punojmë të shtytur nga përkushtimi ynë ndaj idesë së KOMRA-s dhe nga qëndrimi se është e nevojshme që Koalicioni për KOMRA të ruhet, kurse funksionimi i tij të përshtatet në mënyrë që të jetë i organizuar në mënyrë demokratike, të jetë rrjet i gjallë aktiv në avokimin e idesë së KOMRA-s dhe i përkrahjes, le të shpresojmë, së komisionit të ardhshëm rajonal. Për ne është me rëndësi që si grup punues ta përgatisim dokumentin, i cili në kuvend do të nxis përgjigje konstruktive.

Pasi që kuvendi na e ka dhënë detyrën/mandatin që deri në Kuvendin e ardhshëm të përgatisim propozimin e modelit të ri të qeverisjes, ne propozojmë edhe ndryshime të statutit të Koalicionit për KOMRA në përputhje me modelin e ri të propozuar.

Para disa muajsh, më saktë në datën 26. 06. 2014, i ka skaduar mandati Këshillit Koordinues të Koalicionit për KOMRA, të zgjedhur në kuvendin në Sarajevë të datës 26. 06. 2011. Mandati i anëtarëve dhe i anëtareve të Këshillimit Koordinues ka zgjatur 3 vite, ashtu siç është përcaktuar në nenin 22 të Statutit të Koalicionit për KOMRA.

Grupi punues ka arritur pajtimin që t'i propozojë Kuvendit dy **modele të qeverisjes:**

Modeli 1

Propozojmë që koalicionin ta qeverisë një organ i ri drejtues me emrin **Këshilli Rajonal i Koalicionit për KOMRA**. E propozojmë këtë emër, sepse konsiderojmë se është me rëndësi

të theksohet se është fjala për një organ rajonal dhe dëshirojmë që edhe nga titulli të shihet se roli i atij organi nuk është më koordinimi, por përcjellja dhe përkrahja e procesit si dhe shqyrtimi dhe harmonizimi lidhur me çështjet kyçe për zhvillimin/realizimin e KOMRA-s midis dy kuvendeve.

Roli i Këshillit Rajonal të Koalicionit për KOMRA do të ishte **integrues**. Këshilli Rajonal do të përkrahte punën e organizatave më aktive, të cilat veprojnë përmes partneritetit rajonal krahas përfshirjes dhe marrjes parasysh të mendimit dhe të aktiviteteve edhe të anëtareve të tjera të Koalicionit.

Këshilli Rajonal i Koalicionit për KOMRA do të përbëhej nga 9 persona të 9 organizatave (me zëvendësit e tyre) dhe do të takohej sipas nevojës, së paku njëherë në vit. Takimet do të mund të organizoheshin si takime fizike ose me anë të internetit (për shembull, me anë të lidhjes së Skype).

Anëtarë/e të Këshillit Rajonal të Koalicionit për KOMRA do të ishin përfaqësuesit/et e organizatës, e cila e ka marrë rolin e koordinimit kombëtar/vendor (me fjalë të tjera, e cila është zgjedhur ose janë të zgjedhura nga ana e anëtareve të Koalicionit për KOMRA nga ai shtet/vend për të koordinuar aktivitetet e anëtareve të koalicionit në atë vend). Anëtarin/en do të mund ta konfirmonte kuvendi. Në periudhën midis kuvendeve, anëtarin e ri përkohësisht do të mund ta kooptonte Këshilli Rajonal. Mandati i anëtarit/es do të ishte tre vjet.

Thirrjen e parë të përkohshme të Këshillit Rajonal do ta bënte Kuvendi me propozim të delegatëve të pranishëm krahas obligimit që në mënyrë plotësuese të bëjnë harmonizimin në nivelet kombëtare/vendeve.

Kompetencat e Këshillit Rajonal të Koalicionit për KOMRA do të mund të ishin:

- Shqyrtimi i raportit të avokuesve të Koalicionit dhe dhënia e rekomandimeve;
- Konfirmimi i avokuesve (nëse ndryshohen midis Kuvendeve);
- Këmbimi i informacioneve mbi përparimin/problemet e procesit të avokimit të KOMRA-s në secilin vend individual në nivel rajonal;
- Sipas nevojës, bashkëveprimi në aktivitetet avokuese (për shembull, në dhënien e përkrahjes për nismën në Slloveni, Maqedoni dhe aty ku anëtarët e Koalicionit konsiderojnë se është e nevojshme);
- Përgatitja e letrave të mbështetjes për projektet e ndërlidhura me realizimin e KOMRA-s në nivelet rajonale/kombëtare;
- Pjesëmarrja në afirmimin e KOMRA-s në publik përmes organizimit të ngjarjeve publike dhe
- Thirrja dhe përgatitja e Kuvendit të Koalicionit për KOMRA (që nënkupton përgatitjen e raportit dhe të planit të aktiviteteve, të cilat do të zhvillohen në emër të Koalicionit).

Përgjegjësitë e anëtareve të Këshillit Rajonal do të ishin si më poshtë:

- Organizatat, përfaqësuesit/et e të cilave do të delegoheshin në Këshill, në të njëjtën kohë do të ndërmerrnin edhe obligimin që vet të sigurojnë mjetet për pjesëmarrje në punën e Këshillit (ky është kontributi i anëtares aktive të Koalicionit!)
- Organizatat, përfaqësuesit/et e të cilave do të delegoheshin në Këshill, e marrin përsipër obligimin për funksionim të Këshillit sipas parimit të koordinimit rotativ

njëvjeçar, që do të mund të ndahej në funksionet kyçe – p.sh., një organizatë/anëtar/e do të merrte përgjegjësinë e sigurimit të komunikimit reciprok, konsultimet, takimet; tjetra do të mund të ndërmerre rolin kryesor në organizimin e ngjarjes kryesore dhe takimit (duke përfshirë mbledhjen e mjeteve), kurse e treta kuvendi.

Modeli 2

Mundësia tjetër është që Koalicioni të funksionojë pa organ drejtues, që me statutin e ri të hiqen organet qeverisëse dhe të mbetet organi ekzekutiv i Kuvendit – Sekretariati, kurse statutin e Koalicionit ta ndryshojë në atë mënyrë që ta përkufizojë procedurën e emërimit të Sekretariatit dhe që ta rregullojë marrëdhënien e Kuvendit dhe të Sekretariatit.

Natyrisht se ekziston edhe opsioni i tretë – që Kuvendi të sjellë vendimin që Koalicioni të shuhet, sepse e ka kryer misionin e vet, krahas bartjes së përgjegjësisë për vazhdim të avokimit të Nismës tek Fondi për të Drejtën Humanitare dhe organizatat partnere. Ky grup punues nuk e propozon këtë model.

Dilemat e grupit punues

Emërimi i avokuesve dhe i negociatorëve

Avokuesit dhe negociatorët kanë, në këtë fazë, kurse është për të supozuar se do ta kenë edhe në të ardhmen, rolin kryesor në realizimin e objektivave të Koalicionit. Përveç kësaj, ata përfaqësojnë dhe negociojnë në emër të Koalicionit. Si të rregullohet kjo? Kush do të duhej të propozonte dhe të emëronte avokuesit dhe negociuesit? A duhet që avokuesit të propozohen nga koalicionet kombëtare/vendore e që të konfirmohen nga Kuvendi dhe / ose Këshilli Rajonal midis kuvendit? Propozimi i grupit punues është që ata t'i emërojë Kuvendi, kurse përkohësisht, midis dy kuvendeve, do të mund t'i emëronte Këshilli Rajonal i Koalicionit për KOMRA.

Marrëdhënia e Këshillit Rajonal të Koalicionit, e grupit koordinues dhe e Sekretariatit – përkatësisht koordinimit rajonal të projektit të partneritetit

Një nga pikat kontestuese në funksionimin e qeverisjes së Koalicionit rrjedh nga tendosja midis nevojës së arsyetuar për operativitet, të cilën e ka Fondi për të Drejtën Humanitare si organizatë, e cila kapacitetet e veta ia dedikon punës në realizimin e objektivave të Koalicionit me anë të projekteve rajonale, për të cilat i mbledh mjetet, dhe e cila e ka rolin udhëheqës në zbatimin dhe raportimin para donatorëve, dhe nevojës që Koalicioni të funksionojë sipas rregullave të miratuara dhe të ujditura në mënyrë demokratike. Është e qartë se struktura e tashme drejtuese nuk funksionon më si dhe as që është e përshtatshme në këtë fazë të zhvillimit të nismës për KOMRA. **Propozimi i këtij grupi punues me anë të themelimit të Këshillit Rajonal të Koalicionit shkon në drejtim të vendosjes së marrëdhënieve më të qarta dhe në planin operativ më të pranueshme.**

Propozoj që projektet, të cilat propozohen në emër të Koalicionit (pra, për aktivitetet, të cilat Koalicioni i konsideron kyçe dhe të domosdoshme qoftë për sendërtimin e idesë së KOMRA-s, qoftë për funksionimin e Koalicionit), mund ta kërkojnë përkrahjen nga Këshilli Rajonal i Koalicionit. Pra, që, **megjithëkëtë, të ruhet dallimi midis funksionit qeverisës dhe atij ekzekutiv.** Të gjitha projektet mund të marrin përkrahjen e Këshillit Rajonal.

Pozita e Grupeve Koordinuese

Grupet Koordinuese tash kanë statusin e organeve drejtuese. Kjo nuk funksionon më. Këshilli Rajonal i Koalicionit, në të cilin do të ishin përfaqësuesit/et e organizatës, që në nivel vendor koordinon anëtarët e Koalicionit, e merr këtë rol. Këto, është për të supozuar, do të jenë ato

organizata, të cilat janë aktive – qoftë nëse në disa shtete janë organizata partnere në projektin rajonal, ose në disa janë ato organizata, të cilat nuk janë në projektin rajonal, por janë të zgjedhura për koordinator. Pra, Këshilli Rajonal është fushë e ndërlidhjes së organizatave aktive në projektin rajonal dhe i atyre të cilat nuk duhet të jenë ashtu detyrimisht rreth sjelljes së vendimeve/rekomandimeve, të rëndësishme për realizimin e qëllimit të Koalicionit dhe funksionimin e tij.

Pozita e Sekretariatit

E gjithë ajo që është propozuar do të mund të nënkuptonte thjeshtësim të punës së Sekretariatit dhe heqje të zyrës së parashikuar me Statut. Përndryshe, koordinatorët kombëtar të projekteve rajonale mund të funksionojnë në kuadër të projekteve (për shembull, në projektin e Fondit për të Drejtën Humanitare me organizatat partnere), por nuk do të kishin më rëndësi në funksionimin e Koalicionit për KOMRA. Porse, situatat në Koalicione në vende të veçanta janë mjaft të ndryshme. Në disa vende, anëtarët e Koalicionit rregullisht takohen, kurse në disa të tjera jo dhe, së këndejmi, janë të ndryshme edhe nevojat. Për këtë arsye është e rëndësishme që anëtarët e Koalicionit nga vende të ndryshme, para kuvendit të shqyrtojnë se çka do të thoshte për ta thjeshtësimi i punës së Sekretariatit dhe heqja e zyrave të parapara në Statut.